



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Državna Agencija za Zaštitu Ličnih Podataka
National Agency for Protection of Personal Data

Nr. 05/12

Datë: 22.12.2011

Në mbështetje të nenit 3 paragrafi 2, 3, 4, 5 dhe nenit 49 paragrafi 1 pika 1.1 të Ligjit 03/L-172 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Mbikëqyrësit e Agjencisë morën:

V E N D I M

1. Urdhërohet operatori i telefonisë mobile Z-mobile të bëjë asgjësimin e të gjitha kopjeve fizike dhe elektronike të dokumenteve të depozituara me rastin e verifikimi të të dhënave personale.
2. Të asgjësohen dokumentet e abonentëve të cilët nuk janë aktiv dhe të cilët i kanë kryer detyrimet apo pasi t'i ketë përmbyllur procedurat gjyqësore.
3. Asgjësimi i tyre duhet të bëhet deri më 15. 02. 2012
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Gjatë inspektimit është konstatuar që operatori i telefonisë mobile Z-mobile gjatë regjistrimit të abonentëve depoziton kopje të dokumenteve personale, andaj siç është specifikuar në nenin 3 pika 2, 3, 4, dhe 5 të Ligjit 03/L-172 për mbrojtjen e të dhënave personale, depozitimi i këtyre të dhënave e ka tejkaluar qëllimin për të cilin përpunohen.

Këshillë Juridike

Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa por mund të hapet konflikt administrativ në Gjykatën kompetente në afatin prej 30 ditësh.

Mbikëqyrës Shtetëror
Državni Nadzornik

Mentor Hoxhaj

Bekim Demiri

Aleksandar Spasic

Vendimi i dërgohet:

- Anëtarëve të Këshillit të Agjencisë
- Operatorit të telefonisë mobile Z-mobile
- Arkivit të Agjencisë

